



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA KUSHTETUESE
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT

Nr. 26/2022 (JR)

Nr. 26/ 6 regj.

Tiranë më 10.12.2024

SHPALLJE

E

NJOFTIMIT PËR ZHVILLIMIN E GJYKIMIT TË ÇËSHTJES NË SEANCË PUBLIKE

Nëpërmjet kësaj shpallje, Kolegji i Posaçëm i Apelit, bazuar në nenin 65, pika 1 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, njofton subjektet e procesit, si dhe të gjithë personat e interesuar, se më datë 10.12.2024, ora 10:30, trupi gjykues gjatë shqyrtimit mbi bazë aktesh në dhomë këshillimi, të çështjes me numër regjistri (JR) nr. 26/2022, datë 16.06.2022, për ankimin e subjektit të rivlerësimit Eriselda Bala kundër vendimit nr. 523, datë 07.04.2022 të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në nenin 51, pika 1, të ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar, vendosi shqyrtimin e çështjes në seancë gjyqësore me praninë e subjektit të rivlerësimit, me qëllim konstatimin e saktë dhe të plotë të situatës faktike që lidhet me mënyrën e pagesës së çmimit të apartamentit në pronësi të subjektit të rivlerësimit të ndodhur në qytetin e Tiranës.

Seanca gjyqësore publike do të zhvillohet në **datën 13.01.2025 ora 10:00**, në selinë e Kolegjit të Posaçëm të Apelit, në adresën Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, nr. 3, Tiranë.


Trupi Gjykues, përbëhet nga gjyqtarët:

Kryesues i Trupit Gjykues	Sokol Çomo
Relatore e Çështjes	Ina Rama
Gjyqtare	Albana Shtylla
Gjyqtare	Rezarta Schuetz
Gjyqtare	Mimoza Tasi

Bazuar në nenin 460, pika 5 e Kodit të Procedurës Civile dhe nenin 51, pika 2 të ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar, kjo shpallje bëhet të paktën 10 ditë para seancës gjyqësore, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelit dhe në ambientet e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit. Ky njoftim bëhet gjithashtu edhe në faqen e internetit të Kolegjit

të Posaçëm të Apelit dhe atë të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, si dhe me njoftim individual në adresën elektronike alternative të subjektit të rivlerësimit.

**KRYESUES I TRUPIT GJYKUES
GJYQTAR**



SOKOL ÇOMO

